



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS KAMENICË

Numri i lëndës: 2024:051737

Datë: 21.05.2024

Numri i dokumentit: 05715334

P.nr.22/2024

Gjykata Themelore në Gjilan-Dega në Kamenicë, Departamenti i Përgjithshëm, Gjyqtarit Sadri Krasniqi, me bashkëpunëtorin profesional Ali Kryeziu, duke vendosur sipas detyrës zyrtare në çështjen penale kundër të pandehurve, I. P. nga, dhe J. F. nga, për shkak të veprave penale lëndim i lehtë trupor nga neni 185, paragrafi 1, nën para. 1.4 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan, PP.II.nr.138/2024, të datës 09.02.2024 dhe Marrëveshjes për zgjidhjen e ndërmjetësuar me nr. ND.12/24, të datës 17.05.2024, më datë 21.05.2024, hartoi këtë:

A K T V E N D I M

I. APROVOHET Marrëveshja për zgjidhjen e ndërmjetësuar ND.12/24, e datës 17.05.2024, e lidhur ndërmjet të pandehurve, I. P. nga, dhe J.F. nga përkitazi me Aktakuzën PP.II.nr.138/2024, e datës 09.02.2024.

II. H U D H E T aktakuza e Prokurorisë Themelore në Gjilan, PP.II.nr.138/2024, e datës 09.02.2022.

III. PUSHOHET procedura penale ndaj të pandehurve, I. P. nga . dhe J. F. nga fsh. për shkak të veprës penale: lëndim i lehtë truporë nga neni 185, paragrafi 1, nën para. 1.4 të KPRK-së, *pasi që në mes palëve është arritur marrëveshja në procedurë të ndërmjetësimit.*

Shpenzimet e procedurës penale paguhen nga mjetet buxhetore të kësaj gjykate.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm, me aktakuzën, PP.II.nr.138./2024, e datës 09.02.2024, ka propozuar që ndaj të pandehurve, I.P. nga dhe J.F. nga, për të fillohet dhe shtjellohet procedura penale, për shkak të veprës penale: lëndim i lehtë truporë nga neni 185, paragrafi 1, nën para. 1.4 të KPRK-së, të shpallen fajtorë dhe të dënohen sipas ligjit.

Gjykata shqyrtoi aktakuzën dhe pas vlerësimit të së njëjtës dhe shkresave tjera të lëndës konstatoi se aktakuza është e bazuar në ligj, andaj duke vepruar sipas të njëjtës, ka caktuar seancë gjyqësore për shqyrtimin fillestar kundër të pandehurve për dat.14.05.2024, në të cilën seancë gjyqësore prezantonin, Prokurorja e shtetit dhe të pandehurit I. P. nga R. dhe J. F.. Në fillim të kësaj seance, të pandehurit i propozuan gjykatës që seanca gjyqësore të shtyhet për kohë të pacaktuar dhe kjo çështje penale ndaj tyre të dërgohet për zgjidhje me procedurë të ndërmjetësimit, të cilin propozim e për krah prokurorja e shtetit.

Gjykata duke vepruar sipas propozimit të pandehurit, më datën 14.05.2024, lëndën i ka dërguar për procedurë të mëtutjeshme Referentit për ndërmjetësim në Gjykatën Themelore në Gjilan-dega në Kamenicë.

Referenti për ndërmjetësim më dat.17.05.2024, e njofton Gjykatën se lidhur më çështjen penale P.nr.22/2024, më 17.05.2024, pranë kësaj Gjykate, në procedurën e ndërmjetësimit është lidhur Marrëveshja për zgjidhjen e ndërmjetësuar me nr. ND.12/24, në mes të pandehurve I. P. nga, dhe J. F. nga

Gjykata, pas shikimit dhe analizimit të shkresave të lëndës, konstatoi se në këtë çështje penale duhet hedhur aktakuzën e lartcekur të Prokurorisë Themelore në Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm, si dhe pushoi procedurën penale ndaj të pandehurve I. P. nga R., dhe J. F. nga, ngase më datë 17.05.2024 në mes palëve është arritur marrëveshja në procedurë të ndërmjetësimit.

Andaj, duke u bazuar në këto që u cekën më lart, gjykata, duke u bazuar në nenin 229, paragrafi 4, të Kodit të Procedurës Penale, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS KAMENICË –
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM , DIVIZIONI PENAL**

2024:051737, 21.05.2024

Gj y q t a r i,

Sadri Krasniqi, d.v

KËSHILLA JURIDIKE : Kundër këtij aktvendimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej 3 ditëve nga dita e pranimit të të njëjtit. Ankesa në kopje të mjaftueshme i dorëzohet kësaj Gjykate.